



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Departamenti i *së Drejtës* në *Fakultetin Ekonomik* në Universitetin e Elbasanit “Aleksander Xhuvani” për nevojat e tij, për mbulim të nevojave të procesit mësimor, për vitin akademik 2022-2023 shpall konkurs për personel akademik me kohë të pjesshme

**Kriteret e përgjithshme e të veçanta** për pozicionin e punës **personel akademik me kohë të pjesshme** për konkurrim janë:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet universitare (Ba dhe Master i Shkencave ose ekuivalente me të) brenda ose jashtë vendit në fushën e *Drejtësisë dhe disiplina të integruara me të*, me notë mesatare mbi 8(tetë) (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
2. Preferohen kandidatë me tituj e grada shkencore. Gradat e fituara brenda ose jashtë vendit e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri)
3. Preferohen kandidatë me përvoja të mëparshme në mësimdhënie.
4. Cv e vlerësuar në tërësinë e saj dhe pasja e një profili publik të kandidatit përbën kriter preferencial.
5. Mospasja e konfliktit të interesit të kandidatit me ushtrimin e detyrës në UE.
6. Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të BE-së të mbrojtur dhe e vërtetuar me dëshmi.
7. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna.
8. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Kandidatët **duhet të dorëzojnë** nga data **14.09.2022** deri **23.09.2022** këto dokumente

1. Kërkesë me shkrim (Plotësimi i formularit te aplikimit)
2. Jetëshkrimi.
3. Kopje të diplomës dhe të listës së notave. (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuara jahtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
4. Dokumentacionin shoqërues përkatës origjinal ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura etj.
5. Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për eksperiencën e punës.
6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore(Dëshmi penaliteti)
7. Raporti i aftësisë në punë.
8. Fotokopje e letërnjoftimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
REKTORI**

9. Librezë shëndetësore.
10. Leje nga punëdhënësi për mësimdhënie në UE

Përveç konkurrimit me dosje aplikantët do t'i nënshtrohen *intervistës* në departament.

Dokumentacioni i kërkuar mund të dorëzohet në rrugë postare **14.09.2022** deri **23.09.2022**.

**Adresa postare:**

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,  
Rruga “Ismail Zyma”,  
Aplikim në Fakultetin Ekonomik  
Departamenti i së Drejtës  
Elbasan**